

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8JH-1  
B21

VEHBI  
BALA

BURIM  
POEZIE


vjersha

814-1  
B21.

VEHBI BALA

# BURIM POEZIE

*vjersha*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

ALBRI BAIK

416  
128

# BURIM POEZIE

disponible

Tirazhi 2000 kopje

Format 70 x 100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1977

# S H Q I P È R I !

Fushë e kuqe, shkabë e zezë  
me dy krerë,  
yll i zjarrtë, rezendezë,  
Shqipëri, moj lulekezë,<sup>1)</sup>  
shkëmbi lerë!

Tokë e larë djersë e lotë,  
gjak vaditë,  
buzë detit rrahur shqotë,  
Shqipëri, kala në botë,  
male ngritë!

Shpatëzhveshur duke çarë  
historinë,  
popull trimash luftëtarë,  
lapidarët ngre pishtarë  
për lirinë.

---

1) lule, kurorë

Zemër, mendje e vegjëlisë,  
Parti e Punës,  
prijse e shqyt i Shqipërisë,  
si zgalem drejt lartësisë  
shkon furtunës.

## SHQIPËRIA

Shqipëria është e rëndë e njohur  
me që kemi  
një vlerë historike  
që nuk mund të përcaktohet  
të paktën

Shqipëria është e rëndë e njohur  
një vlerë historike  
që nuk mund të përcaktohet  
të paktën

Shqipëria është e rëndë e njohur  
një vlerë historike  
që nuk mund të përcaktohet  
të paktën

## BURIM POEZIE

Plajat kthehen në brezare,  
xehet<sup>1)</sup> në metalurgji,  
nafta-lumë, që rrjedh ujvare,  
lumi-mijra kuajfuqi.

Njerzit ngrehin vepra t'reja,  
veprat rrisin njerz të rinj.

Buk', çelik e drit' — beteja,  
kthehen tok në poezi...

---

1) minierë

## K A N O N I E R È T\*)

Parakalojnë detrave dy flota  
me topa plim, avionë edhe silurë:  
rrëfejnë forcën që t'u bindet bota;  
në mos, ta kthejnë botën në qivurë.

Dhe përshëndeten si të egrat frota,<sup>1)</sup>  
të ndajnë si piratët pren' dikur.  
Dhe pregatiten të shpërthejë sqota  
e përmbi glob të sulen me zhumhur.

Ku vete njëra, aty tjetra shkon  
dhe kudo ngulen aty kallin zjarr.  
Po zjarr ndaj tyre urejtja ndez duhi:

luftojnë vendet pér pavarësi,  
luftjonë kombet pér çlirim kombtar  
dhe ngrihen popujt pér revolucion.

---

\*) luftanijet e dy superfuqive

1) ordhi

## MARSHI I BRIGADES SË 27-të SULMUESE<sup>\*</sup>

Me zjarr sulmon nëpër beteja  
Brigada e njëzeteshetatë.  
Përpara për fitore t'reja  
s'e ndal armik e as shtrëngatë.

Ne, bijt' e Shqipërisë,  
për popull e Atdhe,  
luftëtarët e lirisë  
vërsulemi rrufe.  
Të lidhur dora-dorë  
punëtorë dhe fshatarë,  
do t'i dërrmojm' prorë  
fashistët gjakatarë.

Sulmo, sulmo, Brigada jonë!  
Armiqt e egër shpartallo!  
Për çështjen e liris' gjithmonë  
fitore korrim ne kudo.

Ne, bijt' e Shqipërisë...

---

<sup>\*</sup>) U muzikua nga Prenkë Jakova si marsh i Brigadës.

## R R A P I

Në zemrën e qytetit të veriut,  
ku linda i dëshiruar një shëndre  
dhe shtegëtimin nisa të njeriut,  
qëndron një rrap me kokën gjer në re.

Të thella i ka rrënjët ai në dhë  
sikur heroi në popull dhe gjeniu.  
Ndaj i qëndron murrërit dhe veriut.  
përjetësisht me hijeshi të re.

Më lart pallate e oxhaqe u ngritën sot  
se rrapi me qytetin moshatar.  
Por, prapë, ai mbeti, për të gjatë mot,  
i së kaluarës një dëshmitar.  
Brezni, që vanë, s'e harruan dot.  
Pasardhësve ua lëmë më krenar.

## MIRËNJOHJE

Kalon, si kalimtarët e rëndomtë,  
dhe rrëth e qark si ata i hedh ti sytë,  
por jo të gjith' si ti ndjejn' krenarinë,  
tek shohin veten rrugës përsëdytë.

T'u zbardhën flokët dhe t'u çelën rrudhat  
të thella dhe të ashpra në fytyrë,  
por jo të gjithë e ndjejn' kënaqësinë  
si ti, tek shohin gjurmët në natyrë.

Se mure ngrite shumë edhe çati,  
se vetë u ngrite lart në hapësirë,  
prandaj në ty e ngatjetojn' njerinë  
aq kalimtar' të dashur dhe të mirë.